



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 186/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01/04/2016 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomik “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. Ref 20769-12-22-2015 me objekt “*Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT*” me fond limit 21,190,527.72 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.01.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. si edhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “A 2000” sh.p.k. “Safe” sh.p.k., “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Securitit” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., dhe operatorëve ekonomikë “Toni

Security” sh.p.k., dhe “Eurogjici Security” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimin e vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “A 2000” sh.p.k. dhe “Dea Security” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimin e vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k., “Ales” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k “Aulona Pol 1” sh.p.k. “N.S.S.” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

BO “Lura Security” sh.p.k.

& “International Security Albania” sh.p.k.

Adresa: Rr “Jordan Misja” Kompleksi “Gener 2”, Tiranë

“Nazeri 2000” sh.p.k.

*Adresa: Rruga “Kavajës” Qendra Condor, Kulla H, Ap 27
Tiranë*

“N.S.S.” sh.p.k.

*Adresa: Bulevardi Zogu I, Ndërtesa 53, Kati 3
Tiranë*

BO “Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k.

*Adresa: Lagjia “Kastriot” Rr. “Brigada e 11 Sulmuese”, godina
“Albtelecom”, kati 3, Fier*

BO “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k.

*Adresa: Rruga “Bernard Billota” Kulla “Haëai-Toëer” Pazar 2,
Kati 1, Njësia Bashkiake Nr.11, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar i Traumës

*Adresa: Rr. “Lord Bajron”, Laprakë
Tiranë*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.12.2015 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 207691-12-22-2015 me objekt “Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT” me fond limit 21,190,527.72 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.01.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2 . Në datën 15.01.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor dhe pretendimeve të operatorëve ekonomikë, në datën 03.02.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoni si më poshtë vijon:

1. “Eurogjici-Security” sh.p.k.	20,144,290.522 Lekë	kualifikuar;
2. “Toni Security” sh.p.k.	20,144,290.522 Lekë	kualifikuar;
3. “N.S.S” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	kualifikuar;
4. “Ales” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	skualifikuar;
5. “Aulona Pol 1” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	skualifikuar;
6. BO “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	kualifikuar;
7. “Siguria” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	kualifikuar;
8. “A.2000” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	skualifikuar;
9. “BO “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	skualifikuar;
10. “SSX sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	skualifikuar;
11. “Global Security” sh.p.k.	20,181,455.94 Lekë	skualifikuar;
12. “Dea Security” sh.p.k.	20,214,882.76 Lekë	kualifikuar;
13. “Nazeri 2000” sh.p.k.	20,214,882.79 Lekë	skualifikuar;
14. “Myrto Security” sh.p.k.	20,214,882.84 Lekë	kualifikuar;
15. “Firdeus Security” sh.p.k.	20,214,882.84 Lekë	skualifikuar;
16. “Oktapus” sh.p.k.	20,214,882.84 Lekë	skualifikuar;
17. “Arbana Sh.A” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	
18. “Trezhnjeva” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	

II.4. Në datën 09.02.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k.& “International Security Albania” sh.p.k. kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k si oferta nën minimumin ligjor për procedurën e prokurimit.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Vendimi i KVO për të kualifikuar ofertat e “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k. është në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë kryerjen e këtij shërbimi. OE të sipërcituar nuk kanë respektuar detyrimet për pagën minimale, shtesat mbi pagë për turnet II dhe III, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si edhe detyrimet për taksën e armatimit në përputhje me kërkesat e AK për ti respektuar këto detyrime për 4.81 roje për vendroje 24 orarëshe për shërbimin e kërkuar për 11.4 muaj dhe preventivit të përcaktuar në DST. Konkretisht nuk është respektuar kërkesa nr.5 “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, ku thotë që: “Oferta duhet të shoqërohet me analizë çmimi. Në analizën ofertuesi duhet të kenë parasysh të dhënat e tabelës në shtojcën 11 pika 3” në DST. Konkretisht këto zëra nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe sipas grafikut në shtojcën nr.11 të DST. [...]”

II.5. Në datën 11.02.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.121/1 prot datë 11.02.2016 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën.

II.5.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...]Ju sqarojmë se përsa i përket pikës së dytë të ankesës Suaj për skualifikimin të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. ashtu siç citoni në Formularin e Ankesës për arsye se kanë bërë ofera nën kosto dhe në kundërshtim me ligjin, grupi i punës, mbasi shqyrtoi ofertat nuk gjeti shkelje të ligjeve cituar në ankesë dhe ofertat ishin të përlllogaritura në rregull.[...]”

II.6. Në datën 12.02.2016 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6.1. Në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së duke shtuar edhe argumentet se “[...] Kërkojmë të rishikohet vërtetimi i OSHEE nëse është bërë pagesa për muajin e fundit/ Kërkojmë ti rishikohet vërtetimi i AKEP nëse është në rregull dhe a janë kryer pagesat për vitin 2016 pasi në specifikimet teknike në DST shtojca 9, pika 3 kërkohet që rojet për të kryer shërbimin duhet të kenë radio komunikim, rrjedhimisht duhet të jetë brenda ligjeve në fuqi autorizimi nga AKEP dhe pagesat për vitin 2016 të jenë kryer që të lindi e drejta e përdorimit të radioneve të dorës me frekuencë e lëshuar nga AKEP.[...]”

II.7. Operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “[...] Zotëron kontrata të ngjashme dhe vërtetime me institucionet private por faturat tatimore nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore. OE nuk ka paraqitur vërtetim për numrin e punonjësve për vitin 2014 të

shoqëruar me listëpagesat E-Sig dhe formularët e deklarimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Mungojnë formularët e deklarimit të pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014.[...]

II.8. Në datën 08.02.2016, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij si edhe kundërshtimin e vendimit të KVO-së kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “A 2000” sh.p.k. “Safe” sh.p.k., “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k., në procedurën e e prokurimit objekt ankimi.

II.8.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit, shoqëria jonë ka paraqitur kontrata të lidhur me autoritetin kontraktor AlbControl, pra për kontrata me autoritetet shtetërore AK nuk ka kërkuar fare fatura tatimore dhe shoqëria jonë i ka vendosur këto fatura duke tejkalluar përmbushjen e kërkesës së AK pasi kemi vendosur edhe kontratat edhe vërtetimin nga institucioni shtetëror për realizimin e kontratës. Në lidhje me arsyen e dytë, në total AK ka kërkuar që OE të ketë 40.15 çdo muaj për 24 muaj, me listëpagesat e paraqitura ka dëshmuar se kapacitetet e shoqërisë përmbushin kërkesën e AK, pasi numri i tyre është 6 fish më shumë. Gjithashtu shoqëria ka paraqitur vërtetim nga organet tatimore për vitin 2014 për numrin e punonjësve të siguruar. Së treti autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “A 2000” sh.p.k. “Safe” sh.p.k., “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k. pasi në total oferta e tyre është nën minimumin ligjor. Së katërti autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “A 2000” sh.p.k. “Safe” sh.p.k., “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k. pasi këto shoqëri nuk kanë paraqitur tabelën e dhënë nga AK sipas shtojcës 11 pika 3 si edhe nuk kanë paraqitur analizën e kostos në përputhje me të dhënat e tabelës.[...]”

II.9. Në datën 11.02.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.117/1 prot datë 11.02.2016 i kthen përgjigje palës ankimuese duke pranuar pjesërisht ankesën.

II.9.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Sqarojmë se grupi i punës mori në shqyrtim dosjen elektronike nga ana e KVO-së dhe vlerësoi se kontratat e dorëzuara nga Ju dhe faturat tatimore të paraqitura plotësojnë kriteret e sipërpërmendura mbi vlerën 40% të kontratës. Grupi i punës pasi rishikoi dokumentet e paraqitura nga ana OE, konstatoi se “Vërtetimi për numrin e punonjësve për vitin 2014 të shoqëruar me listëpagesat E-Sig si edhe formularin e deklaramit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mungon. Mungojnë dhe formularët e deklaramit të pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014.Pra kriteret e veçanta pika 3 nuk plotësohet. Pretendimi nuk qëndron. Përsa i përket skualifikimit të ofertave të operatorëve ekonomike, grupi i punës pasi shqyrtoi ofertat nuk gjeti shkelje të ligjeve cituar në ankesë dhe ofertat ishin të përlllogaritura në rregull. Ndërsa përsa i përket OE “Ales” sh.p.k. dhe “Aulona Pol I” sh.p.k. ju sqarojmë se këta dy OE janë skualifikuar nga KVO për mosplotësim të kriterëve të veçanta për kualifikim, kështu që ofertat e tyre janë automatikisht të skualifikuara. [...]”

II.10. Në datën 18.02.2016 operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Në datën 02.02.2016, operatori ekonomik ankimues “N.S.S.” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k si edhe të bashkimit të operatorëve ekonomikë bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Ofertat e shoqërive “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. nuk kanë respektuar kostot minimale që përcaktojnë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë për shtesat mbi pagë, për koston e armatimit dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si rrjedhojë duhet të skualifikohen si oferta nën koston ligjor. Kërkojmë nga autoriteti juaj kontraktor një rishikim zë për zë, preventiveve përkatës dhe analizat e kostove shoqëruese për të kuptuar që nuk janë zbatuar të gjitha kostot që parashikon ligji. Kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga firma “Lura Security” pasi në dijeninë tonë nuk i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të DST si më poshtë: Nuk ka vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Nuk ka vërtetim për numrin e punonjësve të certifikuar konform ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të ndryshuar, shoqëruar me listën emërore, certifikatat, lejet e punonjësve të

certifikuar, lëshuar nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë, jo më pak se 40.15 punonjës. Nuk ka akt miratimin e DPQ Tiranë për Qendrën e Kontrollit (Sallën Operative) në zbatim të ligjit 75/2014 për “SHPSF-të”. Nuk ka vërtetim nga dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet (2012,2013,2014) ku vlera mesatare e tyre të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Nuk ka vërtetim lëshuar nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Dhjetor 2014 dhe Janar-Shtator 2015, jo më pak se 40.15 punonjës shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig 025/a) si edhe formularët e deklarimit të pagesës për sig. Shoqërore dhe shëndetësore. Nuk ka shërbime të së njëjtës natyrë në një vlerë prej 40 % të vlerës së fondit limi për të cilat oferutesi konkurren dhe që janë realizuar gjatë 3 viteve të fundit. [...]

II.12. Në datën 10.02.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.103/1 prot datë 10.02.2016 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën.

II.12.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...]Ju sqarojmë se përsa i përket pikës së parë të ankesës Suaj për skualifikimin të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. ashtu siç citoni në Formularin e Ankesës për arsye se kanë bërë ofera nën kosto dhe në kundërshtim me ligjin, grupi i punës, mbasi shqyrtoi ofertat nuk gjeti shkelje të ligjeve cituar në ankesë dhe ofertat ishin të përlllogaritura në rregull. Ndërsa për pikën dy të ankesës grupi i punës mbasi shqyrtoi dokumentet e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. nuk gjeti mungesa në dokumentacionin e cituar në ankesë. [...]”

II.13. Në datën 19.02.2016 operatori ekonomik ankimues “N.S.S” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.14. Në datën 09.02.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “A 2000” sh.p.k. dhe “Dea Security” sh.p.k. si oferta nën minimumin ligjor të lejuar.

II.14.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Referuar dispozitave ligjore ofertat e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k., “N.S.S.” sh.p.k., “A 2000” sh.p.k. dhe “Dea Security” sh.p.k.. janë oferta nën koston ligjore pasi vijnë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nën ligjore të sipërcituara dhe kërkesat e përcaktuara në DST dhe sit ë tilla duhet të refuzohen si oferta nën minimumin ligjor të lejuar. [...]”

II.15. Në datën 22.02.2016 bashkimi i operatorëve ekonomikë Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. kanë paraqitur kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.16. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k. është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se *“[...] Zotëron kontrata të ngjashme dhe vërtetime por nuk ka fatura tatimore të konfirmuara nga organet tatimore..[...]”*

II.17. Në datën 08.02.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k. kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre si edhe kundërshtimin e vendimit të KVO-së kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. , “Eurogjici Security” sh.p.k., “Ales” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. , “Aulona Pol 1” sh.p.k. dhe “N.S.S.” sh.p.k., procedurën e e prokurimit objekt ankimi.

II.17.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: *“[...] Gjykojmë se skualifikimi ynë është bërë në kundërshtim me LPP, neni 46 pika 1 dhe VKM nr.914 neni 28 kontratat e shërbimeve pika 3. Nisur nga çfarë parashikon legjislacioni në fuqi BOE ka dorëzuar kontrata të ngjashme siç pranohet edhe vetë nga KVO-ja në msg online me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore përkatëse konform ligjeve në fuqi për këto arsye konstatimi i KVO-së është i pabazuar në ligj duke ditur se faturat tatimore tërhiqen pranë Drejtorive Rajonale dhe çdo muaj në datën 5 deklarohen online po në faqen dptt.gov.al. për shërbimet e kryera. Duke vazhduar arsyetimin këtë tabelë referuese për analizën e kostos janë të shprehura qartë zërat e shpenzimeve të cilat duhet të merreshin parasysh nga operatorët në hartimin e ofertave të tyre ekonomike duke i bërë pjesë përbërëse të ofertave detyrimet që rrjedhin nga ligjet e sipërcituara. Megjithëse AK i ka vendosur si parakushte zbatimin e këtyre detyrimeve në oferta nga ana e operatorëve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi publik, KVO-ja e ngritur nga ky i fundit për vlerësimin e dokumentacionit ligjor dhe ekonomik të OE pjesëmarrës në vlerësimin e saj ka shkelur haptazi dhe nuk i ka marrë parasysh ligjet e sipërcituar duke përdorur dy ose më shumë standarde për zgjedhjeje. Për këto arsye kërkojmë nga autoriteti kontraktor ti shtojë si arsye skualifikimi dhe të skualifikojë OE “Toni Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Ales” sh.p.k., , “Lura Security” sh.p.k. , “Aulona Pol 1” sh.p.k. dhe “N.S.S.” sh.p.k. si oferta nën koston ligjore të lejuar. [...]”*

II.18. Në datën 11.02.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.109/1 prot datë 11.02.2016 i kthen përgjigje palës ankimuese duke pranuar pjesërisht ankesën

II.18.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Sqarohet se grupi i punës mori në shqyrtim dosjen elektronike nga ana e KVO-së dhe vlerësoi se kontratat e dorëzuara nga Ju dhe faturat tatimore të paraqitura plotësojnë kriteret e sipërpërmendura mbi vlerën 40% të kontratës. Përsa i përket skualifikimit të ofertave të operatorëve ekonomike, grupi i punës pasi shqyrtoi ofertat nuk gjeti shkelje të ligjeve cituar në ankesë dhe ofertat ishin të përlogaritura në rregull. Ndërsa përsa i përket OE “Ales: sh.p.k. dhe “Aulona Pol 1” sh.p.k. ju sqarohet se këta dy OE janë skualifikuar nga KVO për mosplotësim të kriterëve të veçanta për kualifikim, kështu që ofertat e tyre janë automatikisht të skualifikuara. [...]”

II.19. Në datën 22.02.2016 bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.20. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor dhe pretendimeve të operatorëve ekonomikë, si edhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, pas shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë pranë autoritetit kontraktor, në datën 12.02.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Eurogjici-Security” sh.p.k.	20,144,290.522 Lekë	kualifikuar;
2. “Toni Security” sh.p.k.	20,144,290.522 Lekë	kualifikuar;
3. “N.S.S” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	kualifikuar;
4. “Ales” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	skualifikuar;
5. “Aulona Pol 1” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	skualifikuar;
6. BO “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k.	20,164,058.14 Lekë	kualifikuar;
7. “Siguria” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	kualifikuar;
8. “A.2000” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	skualifikuar;
9. “BO “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	kualifikuar;
10. “SSX sh.p.k.	20,164,058.17 Lekë	kualifikuar;
11. “Global Security” sh.p.k.	20,181,455.94 Lekë	kualifikuar;
12. “Dea Security” sh.p.k.	20,214,882.76 Lekë	kualifikuar;
13. “Nazeri 2000” sh.p.k.	20,214,882.79 Lekë	skualifikuar;
14. “Myrto Security” sh.p.k.	20,214,882.84 Lekë	kualifikuar;
15. “Firdeus Security” sh.p.k.	20,214,882.84Lekë	skualifikuar;
16. “Oktapus” sh.p.k.	20,214,882.84 Lekë	skualifikuar;
17. “Arbana Sh.A” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	

18. “Trezhnjeva” sh.p.k.

nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.21. Në datat 24.02.2016 dhe në datën 01.03.2016 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “[...] OE nuk ka paraqitur vërtetim për numrin e punonjësve për vitin 2014 të shoqëruar me listëpagesat E-Sig dhe formularët e deklaramit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Mungojnë formularët e deklaramit të pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014.[...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.1.1. Në “Shtojca 7” “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar “[...]Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar - Dhjetor 2014 dhe Janar – Shtator 2015 jo më pak 40.15 punonjës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig 025/a), si dhe formularët e deklaramit të pagesës së sig. shoqërore dhe shëndetësore .[...].”

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Vërtetim nr.29304/1prot. datë 27.04.2015 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, për “Kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” të subjektit “Nazeri 2000” sh.p.k. për periudhën Janar 2013- Mars 2015;
- ii. Vërtetim nr.5485/1prot. datë 23.07.2015 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, për “Kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” të subjektit “Nazeri 2000” sh.p.k. për periudhën Janar 2015- Gusht 2015;
- iii. Vërtetim nr.75976prot datë 23.10.2015 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, për “Kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” të subjektit “Nazeri 2000” sh.p.k. për periudhën Gusht 2015- Shtator 2015;
- iv. Listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar- Nëntor 2015.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.5. Referuar këkesës së autoritetit kontraktor pasqyruar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi se operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë “[...]Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar - Dhjetor 2014 dhe Janar – Shtator 2015 jo më pak 40.15 punonjës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig 025/a), si dhe formularët e deklaramit të pagesës së sig. shoqërore dhe shëndetësore .[...]” në përputhje me nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, qëllimi i tij të fundit (autoritetit kontraktor) është vërtetimi nga ana e operatorëve ekonomikë se disponojnë fuqinë mesatare punëtoresh prej 40.15 punonjës për periudhën e kërkuar.

III.1.5. K.P.P. konstaton se operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k me dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar në S.P.E. për periudhën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi vërteton se ka shlyer detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni sektorial (Kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore) dhe numrin përkatës të stafit të siguruar për periudhën e kërkuar. Gjithashtu me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. operatori ekonomik ka pasqyruar një panoramë të qartë para autoritetit kontraktor se plotëson dhe tejkalon disa herë numrin mesatar të punonjësve të kërkuar në përputhje me kërkesën e pasqyruar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k.,operatorit ekonomik “Nazeri 2000”, operatorit ekonomik “N.S.S.” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k., “Eurogjici Security” sh.p.k., “NSS” sh.p.k. BO “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. “Siguria” sh.p.k., “BO “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k.“SSX sh.p.k., “Global Security”

sh.p.k. “Dea Security” sh.p.k. me pretendimin se ofertat e tyre ekonomike janë nën minimumin ligjor të lejuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.2. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ndërsa në VKM nr. 573, datë 03.7.2012 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, thuhet se: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”.

III.2.3. Referuar nenit 81 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, “çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtesë mbi page jo më pak se 20% dhe çdo ore pune e kryer midis intervalit 2.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 50%”, ndërsa referuar nenit 87, po këtu, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25 për qind ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj”.

III.2.4. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.2.5. Përveç shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, në koston për një roje në muaj përfshihen edhe shpenzimet minimale të armatimit, sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 3644, dt. 07.12.2001 “Për aplikimin e tarifave në kryerjen e shërbimit ndaj të tretëve”.

III.2.6. Në dokumentat e tenderit “Seksioni I”, “Njoftimi i Kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si “Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër : Objekti i kontratës: Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT Për 1 vendroje me tre turne nevojiten 4.81 roje. Për 7 vendroje 24 orësh nevojiten 33.67 punonjës (24 orësh) / 1 muaj. - Numri i vendrojeve 8 orësh (turni i parë) është 1.08. Për 6 vendroje 8 orësh nevojitet 6.48 punonjës (8 orësh) / 1 muaj; Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Kohëzgjatja në _____ose ditë 348 [...]”

III.2.7. Në “Shtojca 9” “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar “[...] Punonjësit e shërbimit të jenë të licencuar me lejet përkatëse të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të ligjit 8770, datë 19.04.2001 „ Për SHRSF“.

1. Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre.
2. Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.
3. Rojet duhet të kenë leje arme.
4. Rojet e turnit të dytë dhe të tretë të jenë të pajisur me armë.
5. Në vend roje të ketë libër për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
6. Në vend roje duhet të jetë i afishuar grafiku i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.[...]”

III.2.8. Në “Shtojca 12” “Termet e Referencës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar: “1. Objekti dhe qellimi i shërbimeve: **Objektet e përcaktuara në specifikimet teknike do të ruhen nga rojet private të armatosura duke realizuar objektivat dhe detyrat e më poshtëme. Rojet të jenë të pajisur me armë dhe mjete të tjera mbrojtëse, me uniformë të vecantë dhe dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle cdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve** “

III.2.9. Nisur nga baza ligjore e sipërcituar, si edhe duke patur parasysh periudhën e kryerjes së shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, vendrojet ku do të kryhet shërbimi, numri i rojeve dhe turnet përkatëse, si edhe kriteret e kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit (specifikimet teknike, termet e referencës), Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ofertat e operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k., “Eurogjici Security” sh.p.k., “NSS” sh.p.k. BO “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. “Siguria” sh.p.k., “BO “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. “SSX sh.p.k., “Global Security” sh.p.k. “Dea Security” sh.p.k. dhe nga përllogaritjet e bëra rezultoi se ofertat ekonomike të këtyre operatorëve ekonomikë janë nën koston minimale ligjore dhe nuk mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve për periudhën e kërkuar të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje në përputhje me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “N.S.S.” sh.p.k. qëndron.

Pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. qëndron.

Pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k., me argumentet se *“[...] Kërkojmë të rishikohet vërtetimi i OSHEE nëse është bërë pagesa për muajin e fundit/ Kërkojmë ti rishikohet vërtetimi i AKEP nëse është në rregull dhe a janë kryer pagesat për vitin 2016 pasi në specifikimet teknike në DST shtojca 9, pika 3 kërkohet që rojet për të kryer shërbimin duhet të kenë radio komunikim, rrjedhimisht duhet të jetë brenda ligjeve në fuqi autorizimi nga AKEP dhe pagesat për vitin 2016 të jenë kryer që të lindi e drejta e përdorimit të radioneve të dorës me frekuencë e lëshuar nga AKEP.[...]”*

III.3.1. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se këto pretendime janë ngritur vetëm në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimitit përcaktuar në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 63, pika 2, ku parashikohet se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”* Në këtë mënyrë për sa kohë që pala ankimuese nuk ka shtuar së pari ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor mbi arsyet e s’kualifikimit të ofertës së tij, e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë ka rënë në dekadence. Sa më sipër pretendimet e mësipërme nuk merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertat e operatorëve ekonomikë “A 2000” sh.p.k. “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se fati i operatorëve ekonomik është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 03.02.2016 dhe 12.02.2016 sipas të cilit këto shoqëri rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga

autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operator të kenë paraqitur ankim në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.4.1. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomike, “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k, “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm (në lidhje me vlerën e ofertës ekonomike) qëndron dhe oferta e operatorëve të mësipërm ekonomikë pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike e operatorëve ekonomikë “Dea Security” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “Siguria” sh.p.k., “S.S.X” sh.p.k, bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k. “N.S.S.” sh.p.k., “Lura Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” sh.p.k., “Toni Security” sh.p.k. e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. nuk merret në shqyrtim.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “N.S.S.” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., me argumentin se *“pasi në dijeninë tonë nuk i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të DST si më poshtë: Nuk ka vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “d” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“d) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik i regjistruar në Shqipëri”

III.5.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. *Vërtetim Debie Nr.9102 Prot dt.10.12.2015 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me anë të të cilit vërtetohet se:*

[...]verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën me kod TR1titullar i të cilës është I.L rezulton të ketë 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 10.12.2015, pa përfshirë faturën koherente të muajit nëntor 2015.

III.5.3 Në Nenin 28 “Kontrata e Shërbimeve”, pika 4, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: [...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

III.5.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në Nenin 48, pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “ [...] Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë: b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore [...]”

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k. vërteton se ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike deri në muajin tetor 2015. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit 15.01.2016 dhe Nenit 9, paragrafi 1 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k. nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, detyrimet e energjisë elektrike për muajin nëntor 2015 janë maturuar. Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k. nuk përmbush pikën 1, gërmën “d” të Shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.5.6. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.5.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k. nuk ka përmbushur e detyrimet ligjore për shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike sa më sipër oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë në tërësi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “N.S.S.” sh.p.k. qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomikë ankimues “N.S.S” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.7. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertat e operatorëve ekonomikë “Aulona Pol 1” sh.p.k., “Ales” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se fati i operatorëve ekonomikë është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 03.02.2016 dhe 12.02.2016 sipas të cilit këto shoqëri rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operator të kenë paraqitur ankim në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. nuk merret në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., operatorit ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k. , operatorit ekonomikë “N.S.S.” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 20769-12-22-2015 me objekt “Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT” me fond limit 21,190,527.72 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.01.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomik “Toni Security” sh.p.k., “Eurogjici Security” sh.p.k., “NSS” sh.p.k. BO “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k. “Siguria” sh.p.k., “BO “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k. “SSX sh.p.k., “Global Security” sh.p.k. “Dea Security” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke i skualifikuar këta operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguara bashkimi i operatorëve ekonomikë Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., operatorit ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k. , operatorit ekonomikë “N.S.S.” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “ Ballazhi” sh.p.k. bashkimit të operatorëve ekonomikë Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 224 Protokolli; Datë 17.02.2016; Nr. 259 Protokolli; Datë 18.02.2016;

Nr. 261 Protokolli; Datë 19.02.2016; Nr. 280 Protokolli; Datë 22.02.2016;

Nr. 289 Protokolli; Datë 22.02.2016;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri

Mendim Kundër

Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Juliana Hoxha nuk jam dakord me arsyetimin e vendimit dhe dispozitivin e tij për sa i përket ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lura Security” sh.p.k. & “International Security Albania” sh.p.k., operatorit ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k. , operatorit ekonomikë “N.S.S.” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k. & “Ballazhi” sh.p.k. bashkimit të operatorëve ekonomikë Myrto Security” sh.p.k. & “Flena RB” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. Ref 20769-12-22-2015 me objekt “*Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT*” me fond limit 21,190,527.72 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.01.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I. Mbas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatoj se kërkimet e operatorëve ekonomikë ankimues kryesisht ngrihen mbi përllogaritjen e ofertës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, veçanërisht në rast se ofertat e sipërcituara janë përllogaritur duke mbajtur në konsideratë detyrimet ligjore në fuqi. Sa më sipër, gjykoj të ndalem fillimisht në konfuzionin e krijuar nga autoriteti kontraktor në drejtim të hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

I.1. Në seksionin II “*Udhëzime për Operatorët Ekonomikë*”, pika 2 “*Përllogaritja e Ofertës Ekonomike*”, paragrafi 2.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi mënyrën e hartimit të ofertës ekonomike si më poshtë vijon: “*Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkëngjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen.*” Ndërsa në paragrafin 2.3. parashikohet se “*Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.*”

I.2. Vetë akti normative në zbatim të ligjit VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar në nenin 66 pika 4 parashikon se dy elementët kryesore të preventivave në çdo procedurë prokurimi është çmimi për njësi dhe sasia. Gjykoj se operatorët ekonomikë në përllogaritjen e ofertës së tyre ekonomike (në drejtim të çmimit për njësi) duhet të zbatojnë detyrimet ligjore në fuqi. Në Ligjin nr. 75/2014 “*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “*Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Ndërsa në VKM nr. 573, datë 03.7.2012 “*Për përcaktimin e pagës*

minimale në shkallë vendi”, thuhet se: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”. Referuar nenit 81 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, “çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtesë mbi page jo më pak se 20% dhe çdo ore pune e kryer midis intervalit 2.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 50%”, ndërsa referuar nenit 87, po këtu, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25 për qind ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj”. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”. Përveç shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, në koston për një roje në muaj përfshihen edhe shpenzimet minimale të armatimit, sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 3644, dt. 07.12.2001 “Për aplikimin e tarifave në kryerjen e shërbimit ndaj të tretëve”.

I.3. Në rastin konkret, gjykoj se në përlogaritjen e vlerës totale të kryerjes së shërbimit, rol kyç luan edhe periudha (kohëzgjatja) e kontratës publike të shërbimit objekt prokurimi. Në rastin konkret, konstatoj se referuar “Seksioni I”, “Njoftimi i Kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si “Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Kohëzgjatja në _____ose ditë 348”. Gjithashtu nga verifikimet e kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor ka publikuar edhe aktin administrativ “**Sqarim mbi mënyrën se si do të përlogaritet analiza e koston për rojet me turn 24 orarësh dhe rojet 8 orarësh**” në të cilën ndër të tjera ka sqaruar se “[...].Periudha për të cilën do të mbulohet me këtë shërbim është nga data 19.01.2016 deri në 31.12.2016 sipas shtojcës 11 në DST.Duke patur parasysh që sherimi i Ruajtjes së sigurisë me Roje Private në SUT do të vazhdojë për gjithë vitin 2016 (hequr periudha 1-18 Janar 2016 që mbulohet me kontratën shtesë 20%) është bërë përlogaritja e koston për cdo vëndroje me bazë vjetore. Përlogaritja me bazë vjetore thjeshton punën dhe paraqet një analizë kostoje më të saktë sepse të gjitha të dhënat, referuar kodit të punës, VKM-ve dhe udhëzimeve të ndryshme, janë me bazë vjetore.Për vëndrojet me turn 8 orarësh është marrë parasysh vetem pushimi vjetor i paguar. Përsa i përket festave zyrtare, ato nuk janë të përfshira në llogaritje pasi sic është përcaktuar dhe në specifikimet teknike, roja që kryen shërbimin 8-orarësh do të punojë sipas orarit zyrtar pra të shtunë, të dielë dhe ditët festive do jenë pushim.Për vëndrojet me turne 24 orësh janë përlogaritur të gjitha ditët e pushimit vjetor si festivet, leja vjetore dhe ditët e pushimit javor ndërsa nuk janë përlogaritur ditët e lejes në rast sëmundje pasi është lënë në përgjegjësi të operatorit ekonomik pagesa e punëtove që mund të mungojne në rast sëmundje.Numri i vëndrojve 24 orësh sipas specifikimeve teknike është 7. Per 1 vëndroje me tre

turne nevojiten 4.81 roje të përlllogaritur bazuar **në 228 ditë** të punueshme në vit (me 366 ditë). Për 7 vëndroje 24 orësh nevojiten 33.67 roje / muaj. Numri i vëndrojeve 8 orësh sipas specifikimeve teknike është 6. Numri i vëndrojeve 8 orësh (turni i parë) është përlllogaritur bazuar **në 338 ditë** pune në vit (me 366 ditë) ose 1.08 roje për 1 vëndroje turn i parë për gjithë vitin. Për gjashtë vëndroje 8 orësh nevojiten 6.48 roje / muaj. [...]"

I.4. Sa më sipër, gjykoj se autoriteti kontraktor nuk është i qartë mbi mënyrën e përlllogaritjes së kostos për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi në drejtim të kohëzgjatjës së kontratës së mësipërme. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka parashikuar se kohëzgjatja e kontratës është 348 ditë (ose 11.4. muaj), ndërkohë në sqarimin e publikuar për operatorët ekonomikë parashikon një përlllogaritje për një kohëzgjatje të ndryshme nga ajo e publikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjykoj se aktet e mësipërme administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi) si edhe **“Sqarim mbi mënyrën se si do të përlllogaritet analiza e kostos për rojet me turn 24 orarësh dhe rojet 8 orarësh”** shfaqin të dhëna kontradiktore dhe jo të qarta në kuptim të nenit 109 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative. Sa më sipër, gjykoj se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka shkelur parimin e transparencës dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve si dy ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Gjithashtu, referuar **“Shtojca 9” “Specifikimet teknike”** të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar **“[...] Punonjësit e shërbimit të jenë të liçensuar me lejet përkatëse të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të ligjit 8770, datë 19.04.2001 „ Për SHRSF“.** **Public Health Sector**

1. *Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre.*
2. *Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.*
3. **Rojet duhet të kenë leje arme.**
4. **Rojet e turnit të dytë dhe të tretë të jenë të pajisur me armë.**
5. *Në vend roje të ketë libër për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.*
6. *Në vend roje duhet të jetë i afishuar grafiku i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.[...]"*

II. Gjykoj se autoriteti kontraktor shfaq njëherazi të dhëna kontradiktore mbi mënyrën e përlllogaritjes së ofertës ekonomike nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në drejtim të kostos së posaçme për kryerjen e shërbimit duke mos parashikuar në mënyrë të detajuar se për cilat vëndroje kërkohet domosdoshmëria e paisjes me armë dhe në cilat vëndroje nuk shfaqet nevoja e paisjes me armë të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në koston ekonomike të ofrimit të shërbimit. Në këtë mënyrë, gjykoj se

me anë të parashikimeve të mësipërme shfaqen të dhëna kontradiktore dhe jo të qarta duke parashikuar njëherazi detyrimin për paisjen me armë për të gjithë rojet e kryerjes së shërbimit, ndërkohë nga ana tjetër duke veçuar punonjësit (individët) të cilët kryejnë shërbimin në turne të caktuara. Sa më sipër, jam e mendimit se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka shkelur parimin e transparencës dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve si dy ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Bazuar ne nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

Në nenin 27 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të VKM nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; parashikohet se: “ [..]. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”.

Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të VKM, nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”

II.1.1. Sa më sipër, gjykoj se për shkak të shkeljeve të mësipërme të konstatuara procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, pasi referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka shkelur parimin e transparencës dhe barazisë në barazi në

trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve si dy ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si edhe në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe neni 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji. Gjykoj se referuar arsyetimit të mësipërm, për shkak të problematikës së shfaqur nuk mund të gjykohet mbi pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues, por autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e mësipërme.

Vlerësoj se Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike (neni 19/2 i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar), është garant i kontrollit të ligjëshmerisë dhe vlerësimit objektiv të ofertave nga ana e autoriteteve kontraktore (institucioneve dhe enteve publike që realizojnë procedurat e prokurimit) duke shmangur vlersimet subjektive dhe jo të lidhura me dokumentacionin e depozituar nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokuruese.

